



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 60

Prishtinë, më 27.3.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Salih Salihu, Adem Salihaj, Shaip Muja, Murat Hoxha, Time Kadrijaj, Emilija Rexhepi, Haxhi Shala, Sergjan Popoviç.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.3.2017;
3. Shqyrtimi i rekomandimeve për çështjen e Hades;
4. Të ndryshme.

Kryesuesja **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen, sipas rendit të përcaktuar të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës, për këtë mbledhje, u miratua pa ndonjë shtesë.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.3.2017

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 21.3.2017, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve për çështjen e Hades

Kryetarja, Duda Balje, hapi diskutimin rreth çështjes së Hades, ashtu si u kërkuar në mbledhjen e fundit me përmirësimin e rekomandimeve, fillimisht duke ia dhënë fjalën z. **Adem Salihaj** dhe **Murat Hoxha**, mirëpo para se të vazhdonte diskutimi rreth rekomandimeve, **Shaip Muja** apeloj që komisioni mos të zhvillojë diskutimin e rekomandimeve, para se të kërkohej nga Qeveria mendimi se çfarë janë planet e saj për këtë çështje, andaj me pajtim unanim u vendos që Kryesisë së Kuvendit t'i dërgohet:

K ë k e s ë

Komisioni për Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, kërkon nga Kyesia e Kuvendit që, Qeveria e Kosovës, në një afat prej një jave, të dërgojë një raport rreth problemit të Hades, duke përfshirë veprimet e Qeverisë lidhur shpronësimit dhe zhvendosjen e fshatit Hade, pjesa e mbetur, si zonë me interes të veçantë ekonomik.

Pas procedimit të kërkesës në fjalë dhe marrjes së përgjigjes nga Qeveria, komisioni do të vazhdojë me rekomandime apo me veprimet që varen nga njoftimi i Qeverisë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përgatiti: Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Duda Balje